

## RAPORT

### MBI PËRDORIMIN E KONTIGJENCËS PËR PAKETËN E REZISTENCËS SOCIALE NDAJ PASOJAVE TË KRIZËS GJATË PERIUDHËS 1 JANAR- 31 DHJETOR, 2022

1. **Me Aktin Normativ nr. 3**, datë 12.03.2022 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, në Buxhetin e Shtetit u parashikua fondi prej 6 miliardë lekë për financimin e Paketës së Rezistencës Sociale ndaj Pasojave të Krizës, ndërkohë që neni 4, përcakton përdorimin e tij si më poshtë:
  - *Fondi i kontigjencës për Paketën e Rezistencës Sociale ndaj Pasojave të Krizës, prej 6 000 milionë lekësh, për mbështetjen e shtresave në nevojë, për mbështetjen e sektorit të transportit dhe për mbështetjen e sektorit të bujqësisë përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave.*
  
2. **Me Aktin Normativ nr. 12**, datë 29.07.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, ndryshoi në masën 12 100 milionë lekësh, ndërkohë që Neni 4, përcakton përdorimin e tij:
  - *Fondi i kontigjencës për Paketën e Rezistencës Sociale ndaj Pasojave të Krizës, prej 12 100 milionë lekësh, përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave...’*
  
3. **Me Aktin Normativ nr. 17**, datë 1.12.2022 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, ndryshoi në masën 10 220 milionë lekësh, ndërkohë që Neni 4, përcakton përdorimin e tij:
  - *Fondi i kontigjencës për Paketën e Rezistencës Sociale ndaj Pasojave të Krizës, prej 10 220 milionë lekësh, përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave.*

**Deri më 31.12.2022**, fondi i kontigjencës për Paketën e Rezistencës Sociale ndaj Pasojave të Krizës, prej 10 220 milionë lekësh, është përdorur në masën 10 086.9 milionë leke, ose 98.1% e planit dhe konkretisht:

- Rreth 9 694 milion lekë ose 96 përqind e planit, janë akorduar për shpenzime operative (transferata të brendshme).
- Rreth 392.6 milionë lekë ose 4 përqind e planit për shpenzime personeli.

Në mënyrë analitike rezulton se:

- ✓ 1 385 milionë lekë i janë akorduar MSHMS-së me tre VKM si më poshtë:
  - 1 116 milionë lekë me VKM nr. 159, datë 12.03.2022 “Per mbeshtetjen financiare te disa kategorive te vecanta per zbutjen e efekteve te ndikuara nga lufta ne Ukraine”.

- 33 milionë lekë me VKM nr. 616, datë 22.09.2022 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.404 datë 20.06.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së kritereve e të procedurave të përfitimit të kompesimit financiar, nga personat me statusin e të verbërit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse”.
- 236 milionë lekë me VKM nr. 617, datë 22.09.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të ndihmës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike“, të ndryshuar”.
- ✓ *1 700 milionë lekë i janë akorduar MBZHR me dy VKM si më poshtë:*
  - 500 milionë lekë me VKM nr. 245, datë 20.04.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 101 datë 9.02.2022 'Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2022”.
  - 1 200 milionë lekë me VKM nr. 556, datë 29.07.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 101, dt 9.02.2022 "Për përcaktimin e kritereve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2022, të ndryshuar”.
- ✓ *6 437.6 milionë lekë i janë akorduar MFE-së me katër VKM si më poshtë:*
  - 3 883.9 milionë lekë me VKM nr. 159, datë 12.03.2022 “Për mbështetjen financiare të disa kategorive të vecanta për zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta në Ukrainë”.
  - 430 milionë lekë me VKM nr. 225, datë 13.04.2022 “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetëse dhe ndërqytetëse, pjesë e paketës anti-krizë”.
  - 2 003.6 milionë lekë me VKM nr. 605, datë 16.09.2022 'Për indeksimin e pensioneve'.
  - 120 milionë lekë me VKM nr. 569, datë 13.12.2022 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompesimit për shoqëritë e transportit të linjave qytetase, rrethqytetase, pjesë e paketës antikrizë, faza II”.
- ✓ *56.3 milionë lekë i janë akorduar MM me VKM nr. 605, datë 16.09.2022 “Për indeksimin e pensioneve”.*
- ✓ *507.9 milionë lekë i janë akorduar ministrive dhe institucioneve qendrore për përballimin e efekteve financiare nga rritja e pagave në zbatim të VKM-ve përkatëse.*

***Mbështetur në sa mësipër rezulton se, në datën 31.12.2022, gjendja e papërdorur e Kontigjencës për paketën e Rezistencës Sociale ndaj pasojave të krizës është rreth 133 milion lekë.***